



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.247/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Cocaj kryesuese, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Anr.247/2025 e datës 29.01.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1500 ( njëmijepesëqind) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datën 29.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik , Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku pretendohet se në tubimet e Lëvizjes Vetëvendosje, në Drenas në Palestrën e Sportit janë publikuar disa fotografi të ndryshme me të cilën vërehet prezenca e fëmijëve të mitur nën moshën 15 vjeçare, pa prezencën dhe rrjedhimisht pa lejen e prindërve të tyre. Më tutje në ankesë pretendohet se subjekti politik LVV se me këto veprime ka konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar , siç përcaktohet me nenin 5. Par.3 të të Rregullores Zgjedhore 07/2024. Po ashtu në ankesë pretendohet se me përdorimin e fëmijëve të mitur nën moshën 15 vjeçare, janë cenuar rëndë dispozitat e lartcekura dhe gjithashtu ky veprim përbën edhe shkelje të drejtave të fëmijëve të përcaktuara me kushtetut dhe konventa ndërkombëtare pasi që fëmijët nuk mund të përdoren dhe shfrytëzohen për qëllime të organizimit të fushatës zgjedhore.

Kërkojnë nga PZAP, që të nxjerrë vendim të bazuar ankesën e tyre.

Si provë në ankesat kanë bashkangjitur fotografi nga tubimi i mbajtur i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) në Komunën e Drenasit dhe ftesën e publikuar nga Lëvizja Vetëvendosje lidhur me njoftimin për tubim.

PZAP me datë 29.01.2024 iu drejtua për përgjigje në ankesë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje deri me datën 30.01.2025

Në përgjigjen në ankesë të datës 30 janar 2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksojnë se është e paqëndrueshme dhe se ankesa nuk përmban asnjë fakt të shkeljes së nenit .

Par.3 të të Rregullores Zgjedhore 07/2024. Subjekti Politik LVV në përgjigjen e tyre theksojnë se nga provat e bashkangjitura të pretenduesit , LVV nuk është e ndërlidhur me angazhimin e fëmijëve në fushatë: rrjedhimisht nuk ka angazhuar fëmijët në fushatë dhe nuk ka të bëjë me shkeljet e listuara nga pretenduesi PDK në këtë rast. Po ashtu në përgjigje theksohet se nga pretendimet e ankuesit se prezenca e fëmijëve të mitur vërehen se janë pa pëlqimin e prindërve të tyre, parashtruesi i ankesës nuk e ka argumentuar këtë fakt.

Kërkojnë nga PZAP-i të merret vendim lidhur me refuzimin e kësaj ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli ka gjetur se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesave, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik LVV në tubimin e mbajtur për fushatën zgjedhore, kanë marrë pjesë edhe fëmijët, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore*".

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik LVV në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga fotografitë e ofruara si dëshmi nga subjekti politik PDK shihet se në tubimin e fushatës zgjedhore të subjektit politik LVV, e mbajtur në Komunën e Drenasit kanë marrë pjesë edhe fëmijë, me qëllim të përfitimit të votave.

Andaj paneli vlerëson se veprimet tilla janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.247/2025 datë 01.02.2025

Kryesuese e Panelit  
Skender Çoçaj



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.